28 DËSHMI PËR 28 NËNTOR



Prishtinë, 2026

BOTUES:
Gjimnazi i shkencave natyrore “Sami Frashëri”

KRYEREDAKTORE:
Arbenita Vokshi Dobruna

REDAKTORE GJUHËSORE:
Kaltrina Krasniqi

ARTI GRAFIK:
Dion Salihi

Sami Frashëri – mendimtari që projektoi Shqipërinë e pavarur

Sami Frashëri ishte një nga ideologët më të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, i cili me veprën *"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë"* (1899) hodhi themelet e mendimit politik për një Shqipëri të lirë, të bashkuar dhe të zhvilluar. Ai theksonte rëndësinë e gjuhës shqipe, arsimit kombëtar dhe krijimit të institucioneve shtetërore.

Ndonëse ndërroi jetë më 1904, tetë vjet para Shpalljes së Pavarësisë, idetë e Sami Frashërit i paraprinë aktit historik të 28 Nëntorit 1912. Sot, gjimnazi ynë mban me krenari emrin e këtij mendimtari të madh, i cili dijen, arsimin dhe bashkimin kombëtar i shihte si themele të së ardhmes shqiptare.

28 NËNTORI 1912 – DITA KUR FLAMURI KUQEZI U NGRIT NË VLORË

28 Nëntori i vitit 1912 përfaqëson një nga ngjarjet më madhështore dhe më vendimtare në historinë e kombit shqiptar. Kjo është dita kur ëndrra shekullore e shqiptarëve për liri dhe pavarësi u bë realitet, duke shënuar lindjen e shtetit të pavarur shqiptar.



Në prag të këtij momenti historik, gjendja në trojet shqiptare ishte shumë e vështirë. Lufta Ballkanike dhe rreziku i copëtimit të tokave shqiptare e bënin të domosdoshëm bashkimin e përfaqësuesve kombëtarë. Në këto rrethana, Ismail Qemali ndërmori udhëtimin drejt Shqipërisë për të organizuar shpalljen e Pavarësisë.

Më 21 nëntor 1912, Ismail Qemali dhe shoqëruesit e tij zbarkuan në Durrës, ku u përballën me vështirësi për shkak të bllokimit të portit nga dy anije luftarake greke. Pas qëndrimit në qytet dhe përpjekjeve për të komunikuar me atdhetarët e krahinave të tjera, u dërguan telegrame në Berat dhe Elbasan, që Vlora të caktohej si qendër e mbledhjes. Pavarësisht rrezikut të arrestimit nga autoritetet osmane, Ismail Qemali vazhdoi udhëtimin drejt Vlorës, ku mbërriti më 25 nëntor 1912.

Pas mbërritjes, u vendos që Kuvendi Kombëtar të mblidhej më 28 nëntor, në mënyrë që të arrinin delegatët nga krahinat e ndryshme shqiptare. Kështu, më 28 nëntor 1912, në orën 16:00, në shtëpinë e Xhemil Beut, kushëririt të Ismail Qemalit, u hap mbledhja e parë e Kuvendit të Vlorës. Në të morën pjesë përfaqësues nga vise të ndryshme shqiptare, ndër të cilët Iljaz Bej Vrioni, Hajredin Bej Cakrani, Xhelal Bej Skrapari, Dudë Karbunara dhe Taq Dhimitër Tutulani.

Në këtë mbledhje historike, nën udhëheqjen e Ismail Qemalit, u shpall Pavarësia e Shqipërisë. Pas këtij akti madhështor, u ngrit flamuri kuqezi me shqiponjën dykrenare, duke shënuar fundin e një periudhe të gjatë sundimi të huaj dhe fillimin e një epoke të re për kombin shqiptar. Flamuri kombëtar u ngrit edhe në Tiranë, Durrës, Elbasan, Kavajë, Peqin dhe Lushnjë, duke dëshmuar se dëshira për liri dhe bashkim ishte e përbashkët për të gjithë shqiptarët.

Sot, më shumë se një shekull më vonë, 28 Nëntori mbetet simbol i krenarisë, bashkimit dhe identitetit tonë kombëtar. Ai na kujton sakrificat e të parëve tanë dhe na mëson se liria nuk duhet marrë kurrë si e mirëqenë. Detyra jonë është ta ruajmë gjuhën, kulturën, traditat dhe historinë tonë, duke kontribuar për një të ardhme më të mirë.

> *Një flamur u ngrit në Vlorë, por krenaria e tij u përhap në zemrat e miliona shqiptarëve. 28 Nëntori nuk është vetëm një datë historike, por një simbol i përjetshëm i lirisë dhe identitetit shqiptar.*

STINA GASHI

Flamuri kuq e zi



Më 28 nëntor 1443, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu ngriti flamurin në Krujë, duke shënuar një moment të rëndësishëm në historinë shqiptare. Shekuj më vonë, më 28 nëntor 1912, Ismail Qemali ngriti përsëri flamurin në Vlorë, duke shpallur Pavarësinë e Shqipërisë.

Që nga ajo ditë, flamuri nuk është thjesht një copë pëlhure. Është dëshmi e sakrificave, e bashkimit dhe e dashurisë për atdheun. Në çdo valëvitje të tij jeton kujtimi i atyre që luftuan të patrembur!

Flamuri i Shqipërisë është flamuri kombëtar shqiptar, një flamur me fushë të kuqe dhe shqiponjën dykrenare të zezë në mes. Flamuri shqiptar e ka prejardhjen nga një vulë e heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, i cili udhëhoqi shqiptarët në një kryengritje të përbashkët në shekullin XV kundër Perandorisë Osmane, duke i sjellë trojeve shqiptare pavarësinë për një kohë të shkurtër.

Duke marrë parasysh që në të kaluarën ka qenë shumë i përhapur totemizmi (lloj besimi që i adhuronte kafshët dhe shpezët), shqiponja është konsideruar si bashkudhëtare e perëndive dhe vetë perëndi. Shqiponja është simbol pushteti, guximi dhe lartësimi shpirtëror.

Udha e flamurit është udha e shtegtimit drejt pavarësisë së plotë të popullit shqiptar në histori. Nga koha e Skënderbeut e këtej kjo udhë asnjëherë nuk qe e shtruar me lule, por me rreziqe dhe e kurorëzuar me qëndresë. Edhe atëherë kur flamuri ishte i ndaluar, njerëzit e

festonin në vullkanin e ndezur të ndjenjave, e festonin në oda, e festonin në burgje, e festonin me gjakun e trupit.

> *"Flamuri nuk është vetëm simbol i një shteti, por kujtesa e gjallë e një kombi!"*

STINA GASHI

Në 20-vjetorin e Pavarësisë u ngrit varri monumental i Ismail Qemalit në Vlorë



I lindur në Vlorë me arsim dhe jetë administrative osmane, Ismail Qemali u bë figurë e shquar politike. Në vitin 1912 ai udhëhoqi lëvizjen që shpalli Pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria Osmane dhe ngriti flamurin kombëtar shqiptar. Po ashtu, ai u bë kryeministri i parë i vendit.

Me datën 28 nëntor 1932, 20 vite pas Pavarësisë, u përurua varri i Ismail Qemalit në qendër të Vlorës. Skulptori që gdhendi gurin e varrit të Ismail Qemalit ishte Odhise Paskali, një prej skulptorëve më të njohur të Shqipërisë. Varri monumental i Ismail Qemalit u bë monument i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore shqiptare.

BLETA BEQIRI

Dy shkolla në Kosovë mbajnë emrin e Ismail Qemalit





Për nder të babait të shpalljes së Pavarësisë më 1912, sot në Kosovë ka shkolla të cilat mbajnë emrin e tij. Njëra prej tyre është ish-gjimnazi në Ferizaj, monument i mbrojtur i trashëgimisë kulturore, i njohur si shkolla e parë në gjuhën shqipe në këtë qytet.

Ndërsa tjetra gjendet në Prishtinë, në lagjen "Bregu i Diellit", kjo është një nga shkollat më të mëdha të arsimit fillor. Ajo shquhet veçanërisht si shkolla e parë në Kosovë që i është bashkuar Rrjetit Global të Kartës së Arsimit të UNESCO-s.

Bleta Beqiri

Riatdhesimi i eshtrave të Mbretit Zogu I në Shqipëri



Më **28 nëntor 2012**, në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, u organizua një ceremoni e rëndësishme historike: riatdhesimi i eshtrave të Mbretit Zog I nga Franca në Tiranë. Mbreti Zog I, emri i vërtetë i të cilit ishte Ahmet Zogu, ishte një nga figurat më të rëndësishme të historisë shqiptare. Ai ishte mbret i Shqipërisë nga viti 1928 deri në vitin 1939, periudhë gjatë së cilës vendi përjetoi ndryshime të rëndësishme politike dhe shoqërore. Eshtrat e tij u sollën në Shqipëri pas shumë vitesh qëndrimi në Francë, ku ai kishte vdekur në vitin 1961. Ky veprim u konsiderua si një simbol i rikthimit të një figure historike në atdheun e tij dhe i respektit ndaj historisë kombëtare. Ceremonia e riatdhesimit u zhvillua me nderime shtetërore dhe në të mori pjesë një numër i madh përfaqësuesish, qytetarësh dhe familjarësh. Ky moment kishte një rëndësi të veçantë, pasi përkoi me festimin e një shekulli të Pavarësisë së Shqipërisë. Riatdhesimi i eshtrave të Mbretit Zog I mbetet një ngjarje simbolike, që kujton rëndësinë e historisë, identitetit kombëtar dhe respektit për figurat që kanë lënë gjurmë në të kaluarën e Shqipërisë. – Mbreti Zogu I (1895–1961)

> *"Historia nuk është vetëm kujtim i së kaluarës, por edhe një mënyrë për të kuptuar më mirë të ardhmen."*
>
> ANIKA EJUPI

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës merr emrin "Adem Jashari"

Më **28 nëntor 2010**, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës u emërtua zyrtarisht "Adem Jashari", në nder të heroit kombëtar dhe simbolit të rezistencës shqiptare, Adem Jasharit. Ky emërtim ishte një vendim me rëndësi të veçantë historike dhe kombëtare, pasi Adem Jashari përfaqëson guximin, sakrificën dhe luftën për liri. Ai dhe familja e tij u bënë simbol i qëndresës dhe i përkushtimit ndaj atdheut. Emri i tij në aeroportin kryesor të Kosovës përfaqëson një kujtesë të përhershme për sakrificën e bërë për lirinë e vendit. Aeroporti, si një nga portat kryesore të Kosovës për botën, mbart kështu jo vetëm rëndësi infrastrukturore, por edhe një simbolikë të fortë kombëtare. Sot, Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" është një nga institucionet më të rëndësishme të Kosovës dhe emri i tij përcjell mesazhin e lirisë, krenarisë dhe respektit për historinë.





> *"Adem Jashari nuk luftoi për famë, as për kurorë me ar; derdhi gjakun për atdhe, për flamurin shqiptar."*

ANIKA EJUPI

Ndikimi që la pas emri Marigona



Më 28 nëntor 1912, në Vlorë, ngrihet flamuri kuqezi me një shqiponjë dykokëshe në qendër, i cili e ka prejardhjen nga një vulë e heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastriot Skënderbeu, që udhëhoqi shqiptarët në një kryengritje të përbashkët, duke i sjellë trojeve shqiptare pavarësinë për një kohë të shkurtër. Pikërisht këtë vlerë qëndistarja e flamurit,

Marigo Pozio, dëshironte ta njihte sërish populli i saj, pasi flamuri do të valëviste krenarinë dhe lirinë e shqiptarëve.

Atdhetarja nga Korça me origjinë nga Voskopoja, Marigo Pozio, e kujtuar nga historia më ndryshe si "nëna e atdheut" apo "ajo që qëndisi flamurin", kishte një jetë më të gjerë sesa të qëndistares: ajo ishte drejtoreshë e një gazete, poete, veprimtare dhe ktheu shtëpinë e saj në spital për trajtimin e të plagosurve.

Marigoja ishte drejtuese e Organizatës së parë të Grave Shqiptare, të themeluar më 13 maj 1914, nxënësja e 27-të e regjistruar në shkollën e parë shqipe, si dhe nismëtare për hapjen e shkollës së parë në Vlorë, në vitin 1909. Përveç arsimit, luajti rol edhe në letërsinë shqiptare, duke shkruar e botuar një numër të poezive, si dhe në fillim të viteve 1920 ajo drejtoi gazetën "Shpresa Shqiptare", ku në një shoqëri dhe kohë në të cilën fjala publike u takonte pothuajse tërësisht burrave, kjo ishte një zgjatim i natyrshëm i së njëjtës punë.

Për të ndihmuar shqiptarët që erdhën dhe u vendosën në ullishtat e Vlorës gjatë sulmeve greke, ajo punoi së bashku me banorët e Vlorës për të mbledhur ndihma, duke shkuar derë më derë. Gjithashtu, ajo u shkroi letra shqiptarëve të tjerë që jetonin në Amerikë apo gjetkë, duke u kërkuar të kontribuonin për këtë çështje. Fondet e mbledhura me përpjekje të mëdha, ndonëse në kohë lufte, e tejkaluan shumën e nevojshme për ndihmë.

Për kohën që jetoi, ajo kishte një kulturë dhe horizont për t'u admiruar, duke u konsideruar si gruaja më intelektuale e qytetit bregdetar. Edhe pse kontributi i nënvlerësohet vetëm si "qëndistarja e kombit", populli shqiptar e nderon me admirim, një fakt pasi një numër i regjistruar i 3548 vajza dhe gra në Kosovë mbajnë me krenari emrin Marigonë.

ANESA SALIHU

Më 28 nëntor 1997, UÇK-ja për herë të parë shfaqet publikisht




Kaosi që solli kolona serbe më 26 nëntor 1997, duke u kthyer nga Vojniku me armatime të rënda, la plagët e tij në secilën shkollë apo shtëpi që ata sulmuan. Sulmet serbe morën jetën e mësuesit Halit Geci, një personalitet i respektuar ndër shqiptarët, varrimi i të cilit shënoi ndër ditët më të rëndësishme të historisë shqiptare.

Ky varrim, më 28 nëntor 1997 në fshatin Llaushë, publikisht për herë të parë e shfaqi UÇK-në, rezistencën e armatosur më të organizuar të shqiptarëve të Kosovës. Fjalimin e mbajtën Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Daut Haradinaj, të maskuar mirëpo prezentë me uniformën e UÇK-së, të cilët shpalosën qëllimin e luftës çlirimtare. Dalja në skenë ishte një mesazh për t'i treguar popullit që nuk kishte alternativë tjetër përveç një organizimi të armatosur. Kjo rezistencë ishte manifestuar nga dëshira dhe nevoja e popullit shqiptar për liri. Një liri që i është mohuar mjaft gjatë ngaqë Kosova ishte shkëputur nga trungu mëmë gjatë shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912. Ardhja te këto dy data kërkoi mund dhe sakrificë, por me një synim të përbashkët të lirimit të popullit shqiptar. Kjo ndarje, edhe pse joekzistente për shqiptarët, u prit nga armiku ku tashmë thirri shqiptarët e Kosovës si "shqiptarë" dhe shqiptarët e Shqipërisë si "albanski". Për shqiptarët, mohimi i identitetit ishte një përsëritje e historisë dhe ata bënë atë që mund të bënin më mirë: të përgatiteshin së bashku.

ANESA SALIHU

40 nënshkruesit për Pavarësinë e Shqipërisë



Më 28 nëntor 1912, në Vlorë, u mblodhën përfaqësues shqiptarë nga krahina të ndryshme për të vendosur për të ardhmen e vendit. Nën drejtimin e Ismail Qemalit, ata shpallën Pavarësinë e Shqipërisë dhe nënshkruan dokumentin që shënoi krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Në këtë ngjarje historike morën pjesë 40 firmëtarë, të cilët kishin punuar për lirinë dhe bashkimin e shqiptarëve. Disa prej tyre kishin kontribuar në arsim dhe në përhapjen e gjuhës shqipe, ndërsa të tjerë kishin marrë pjesë në lëvizjen kombëtare dhe në përpjekjet për çlirimin e vendit. Ndër figurat më të njohura ishte Ismail Qemali, i cili udhëhoqi shpalljen e Pavarësisë dhe u bë kryetar i Qeverisë së Përkohshme. Luigj Gurakuqi punoi për arsimin shqip, ndërsa Dom Nikollë Kaçorri ndihmoi në organizimin e shtetit të ri. Edhe firmëtarët e tjerë dhanë kontributin e tyre për realizimin e kësaj ëndrre kombëtare. Pas shpalljes së Pavarësisë, Ismail Qemali ngriti flamurin kuqezi në Vlorë. Ky moment shënoi një fillim të ri për popullin shqiptar dhe u bë simbol i lirisë dhe i bashkimit kombëtar. 40 nënshkruesit mbeten pjesë e rëndësishme e historisë sonë, sepse me punën dhe përkushtimin e tyre ndihmuan në krijimin e Shqipërisë së pavarur. Ata na kujtojnë se liria dhe bashkimi janë vlera që duhet t'i ruajmë gjithmonë. Ata ishin: Ismail Qemali, Dom Nikollë Kaçorri, Vehbi Dibra Agolli, Jorgji Karbunara, Elmas Boce, Veli Harçi, Qazim Kokoshi, Jani Minga, Rexhep Mitrovica, Dhimitër Tutulani, Abas Dilaver Çelkupa, Shefqet Daiu, Xhelal Koprencka, Hajredin Cakrani, Iljaz Vrioni, Murad Toptani, Luigj Gurakuqi, Spiridon Ilo, Thanas Floqi, Lef Nosi, Nuri Sojliu, Ferit Vokopola, Ymer Deliallisi, Xhemal Deliallisi, Mustafa Merlika Kruja, Abdi Toptani, Nebi Sefa, Midhat Frashëri, Zihni Abas Kanina Hamzaraj, Qemal Karaosmani Elbasani, Sali Gjuka, Dhimitër Berati, Dhimitër Mborja Emanoil, Dhimitër Zografi, Pandeli Cale, Bedri Pejani, Qemal Mullaj, Myrteza Ali Struga, Aristidh Ruçi dhe Zyhdi Ohri.

PUHIZA KURTESHI

28 nëntor 1959, me rastin e 47-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, u ngrit monumenti i Gjergj Kastriot Skënderbeut në Krujë

Monumenti i Gjergj Kastriotit Skënderbeut ndodhet në qendër të qytetit të Krujës. Është vepër e skulptorit të mirënjohur Janaq Paço, e bërë më 28 nëntor 1959. Kjo është

shtatorja e parë e këtij lloji e ngritur në Shqipëri. Monumenti është rreth 12 metra i lartë, duke përfshirë edhe bazamentin. Gjatë punës për krijimin e monumentit, skulptorit Janaq Paço i silleshin gjithmonë në mendje vargjet e Naim Frashërit për Skënderbeun. Ai i kujtonte ato përmendësh dhe përmes tyre përpiqej ta paraqiste heroin tonë kombëtar sa më mirë.

Vargjet e Naimit për Skënderbeun:

...ish burr' i gjall' e i gjatë,
E në shpatullat i gjerë,
S'ish i ligur e i thatë,
Po ish si lulja në verë.

...kish të gjitha mirësitë
Dhe të tërë urtësinë,
Njerëzin' e dituritë,
Dhe fuqin' e trimërinë.

...kali më fort hingëllinte,
Dhe hidhej si vetëtima,
Asgjësendi s'doj të dinte,
Si rrufeja bij mi trima;

Posi shqipja fluturonte
Edhe ngrihej drejt përpjetë,
Nga goja shkumbë lëshonte,
Thoshnje do të pijë retë...

Skënderbeu duhej të pasqyrohej si një luftëtar trim e i zgjuar, udhëheqës i popullit fitimtar që për 25 vjet me radhë luftoi e mundi hordhitë më të egra të kohës. Duhej të vinte në lëvizje kalin e ta harmonizonte atë me të zotin, t'i konceptonte ata në unitet të plotë dhe së bashku të qëndronin në harmoni.



Kruja u zgjodh si vend për ngritjen e monumentit, sepse ka një rëndësi të veçantë në jetën dhe veprimtarinë e Skënderbeut. Në këtë qytet ai luftoi për popullin shqiptar kundër Perandorisë Osmane dhe organizoi mbrojtjen e vendit. Ngritja e këtij monumenti ishte një mënyrë për të kujtuar sakrificat dhe veprën e Skënderbeut. Sot monumenti i Skënderbeut është një nga simbolet më të njohura të Krujës dhe një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kulturore. Ai na kujton të mos e harrojmë historinë dhe njerëzit që luftuan për lirinë e popullit shqiptar.

PUHIZA KURTESHI

28 Nëntori 1941 – Dita e Flamurit

Më 28 nëntor 1941 u shënua 29-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, në periudhën kur pjesë të Kosovës, Maqedonisë Perëndimore dhe Çamërisë ishin bashkuar me administrimin shqiptar pas rënies së Mbretërisë Jugosllave dhe Greqisë. Kjo rrethanë bëri që për herë të parë pas gati tri dekadash të sundimit dhe politikave shtypëse, shqiptarët në këto treva të kishin mundësinë të kremtonin haptazi, zyrtarisht dhe me simbole kombëtare Ditën e Flamurit.

Për popullin shqiptar të Kosovës dhe viseve të tjera etnike, viti 1941 solli hapjen e shkollave të para shqipe, përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në administratë dhe rikthimin e simboleve kombëtare. Ndonëse kjo periudhë u zhvillua nën hijen e Luftës së Dytë Botërore dhe praninë e pushtuesve italianë e gjermanë, në vetëdijen kolektive ajo u përjetua si çlirim nga regjimi i mëparshëm dhe si një hap drejt bashkimit kombëtar, por një manifestim i fuqishëm i identitetit dhe aspiratave kombëtare.



ZANA BULLATOVCI

28 Nëntori 1941, Dita e Flamurit si simbol i qëndresës kundër fashizmit

Më 28 nëntor 1941, në Gjakovë, me rastin e festës së Flamurit Kombëtar, u organizua demonstrata e parë antifashiste në Kosovë. Kjo ngjarje shënoi një moment të rëndësishëm në historinë e rezistencës kundër pushtimit fashist italian gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sipas historianit Qamil Gexha, në punimin e tij *"Demonstratat antifashiste në Gjakovë gjatë Lëvizjes Nacionalçlirimtare (1941–1943)"*, organizimi i demonstratave ishte një nga format e rezistencës që synonte ndërgjegjësimin dhe mobilizimin e popullsisë shqiptare kundër fashizmit. Demonstrata e 28 Nëntorit u organizua në një ditë me rëndësi të veçantë kombëtare, duke e lidhur festën e Pavarësisë së Shqipërisë me qëndresën kundër pushtuesit. Në këtë mënyrë, Dita e Flamurit mori edhe një dimension antifashist. Organizatorët synonin të demaskonin politikën e pushtuesit italian dhe të zgjeronin përkrahjen për Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Demonstrata e 28 Nëntorit 1941 mbetet një dëshmi historike e ndërthurjes së ndjenjës kombëtare me përpjekjet për çlirim nga pushtimi fashist.

ZANA BULLATOVCI

1922 në jubileun e dhjetë të ngritjes së flamurit filloi të botohej gazeta "Flamuri i Arbërit" në Tiranë

Në vitin 1992, në Tiranë filloi botimin gazeta "Flamuri i Arbërit", në kuadër të 80-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ajo u bë pjesë e historisë së shtypit shqiptar në një periudhë të rëndësishme të zhvillimeve politike dhe shoqërore.

Gazeta kishte karakter kombëtar dhe emri i saj lidhej me simbolin e flamurit shqiptar, i cili përfaqëson lirinë, bashkimin dhe identitetin e popullit tonë. Përmes shkrimeve dhe publikimeve të saj ajo synonte të përcillte vlerat dhe kujtesën kombëtare.

Edhe pse botoi vetëm disa numra dhe nuk pati jetëgjatësi, "Flamuri i Arbërit" mbetet një dëshmi e historisë së gazetarisë shqiptare dhe e rëndësisë që ka fjala e shkruar në ruajtjen e identitetit kombëtar!


ANNO III. Cosenza, 20 Gennaio 1886

FIÀMURI ARBËRI

La Bandiera dell' Albania

PUBBLICAZIONE PERIODICA MENSILE

PER CURA D' UN COMITATO DI SIGNORI D' ALBANIA E DELLE SUE COL

Lettere plichi ed altro inviarsi, franco di porto, all' incaricato della Direzione signor Girolamo de Rada, in MAKI, rione di S. DEMETRIO-CORONE.

ABBONAMENTO ANNUO

Per l' Italia . . . . . .

Per l' Estero . . . . . .

Non si restituiscono i manoscritti.


Drita

E premte, 28 nëntorë 1913

Një vjetori i 28 nëntorit

28 Nanduer 1913.

Traktati I Florencës në muajn e ardhshëm. Çamëria në duar të grekut ?

Më 5 maj 1912

Pse në Vlorë dhe jo në Shkup ?


Shkup brakitset dhe kryeqytja përfundon, pas prezantit, nga qeveria Xhonturke, të 12 nga të plotë të shtruara nga shtypatet.

Me fillimin e Luftës së parë Ballkanike, Shkupi do të pushtohet nga Ellavët. Shpresën e kanë. Prishtinën, do ti jep fund aspiratës për ta shoqëruar pavarësinë në këtë vend.

RIANA ISLAMI

PROF. DR. FATMIRA MUSAJ – STUDIUESJA E FIGURËS SË ISA BOLETINIT

Viti 1952, që shënonte 40-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, lidhet edhe me lindjen e prof. dr. Fatmira Musajt, një emër i njohur në fushën e studimeve historike shqiptare.



Përmes punës së saj shkencore dhe hulumtimeve historike, Fatmira Musaj ka kontribuar në njohjen dhe dokumentimin e figurave të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Ndër figurat që kanë marrë vëmendjen e saj është edhe Isa Boletini, një nga personalitetet më të

shquara të historisë shqiptare, i njohur për qëndresën, trimërinë dhe përkushtimin e tij ndaj çështjes kombëtare.

Isa Boletini mbetet simbol i guximit dhe i dashurisë për atdheun. Jeta dhe veprimtaria e tij përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të historisë së përpjekjeve shqiptare për liri dhe pavarësi. Përmes studimeve dhe dokumentimit historik, figura e tij vazhdon të njihet dhe të vlerësohet nga brezat e rinj.

Rëndësia e historianëve si Fatmira Musaj qëndron pikërisht në ruajtjen e kujtesës sonë kombëtare. Ata na ndihmojnë të kuptojmë më mirë të kaluarën, të vlerësojmë sakrificat e të parëve dhe të mos lejojmë që ngjarjet e figurat e rëndësishme historike të harrohen.

> *Historia nuk jeton vetëm në të kaluarën, por edhe në kujtesën që ne ruajmë dhe në dijen që ua përcjellim brezave të ardhshëm.*

RIANA ISLAMI

28 nëntor 1944 u çlirua Shqipëria nga nazifashizmi

Dëshmitë për çlirimin e Shqipërisë nga nazifashizmi me datën 28 nëntor 1944 lidhen me gazeta dhe fjalime të ndryshme rreth temës së festimit të Shqipërisë së lirë. Kjo lidhet me faktin se historikisht, Shqipëria kaloi dy faza pushtimi:

- 7 prill 1939 – shtator 1943: Pushtimi nga Italia fashiste e Benito Musolinit.
- shtator 1943 – nëntor 1944: Pushtimi nga Gjermania naziste e Adolf Hitlerit, pas kapitullimit të Italisë.

Disa nga dokumentet dhe dëshmitë e festimit të shqiptarëve pas çlirimit nga pushtimi nazifashist janë:

- Dokument zyrtar i vitit 1945: Çlirimi i Shkodrës dhe i Shqipërisë më 28 nëntor 1944:

Në procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, më 5 nëntor 1945, u diskutua data e çlirimit të vendit nga pushtuesit.

Qirjako Harito dhe Tuk Jakova propozuan që si ditë e çlirimit të Shqipërisë të konsiderohej 28 nëntori 1944. Këtu edhe Tuk Jakova deklaroi: "Kur iku okupatori prej Shkodre, (28 nëntor) nuk ngeli ndonjë ushtri e huaj në ndonjë vend tjetër të Shqipërisë." Kjo deklaratë qe mjaft e pranuar nga pjesëmarrësit në mbledhje në bazë të dokumentimit të prof. dr. Valentina Dukës.

- Gazeta e vitit 1944: Çlirimi i gjithë Shqipërisë:

Në Buletinin e Luftës Nacionalçlirimtare, në programin e kremtimit të 28 Nëntorit, njoftohej se festa e Pavarësisë së vitit 1912 përkonte atë vit edhe me festën e çlirimit të Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë. Këtu nuk kemi vetëm një urim për Ditën e Flamurit. Kemi një dokument bashkëkohor që e lidh shprehimisht 28 Nëntorin me çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi.

- Dëshmia ushtarake: Raporti për çlirimin e Shkodrës:

Një dëshmi tjetër gjendet në shënimet e Mehmet Terihatit, ish-komandant partizan, të hartuara në janar 1945. Në to, 28 nëntori përshkruhet si ditë e çlirimit të të gjithë Shqipërisë. Ky material është shqyrtuar edhe nga historianja Ana Lalaj në studimin "Dilema e Çlirimit". Dokumenti u përdor si provë nga komisioni që shqyrtoi datën e çlirimit të Shkodrës në vitin 1993. Megjithatë, Lalaj vëren se pjesët e tjera të raportit tregojnë se luftimet vazhduan gjatë 28 nëntorit, prandaj e kundërshton interpretimin se qyteti ishte çliruar që në mëngjes.

- Komisioni i Institutit të Historisë, 1993:

Më 9 nëntor 1993, Instituti i Historisë përgatiti një relacion për Kuvendin e Shqipërisë mbi datën e çlirimit të Shkodrës.

Në relacionin me nr. protokolli 214, komisioni arriti në përfundimin se Shkodra ishte çliruar më 28 nëntor 1944. Ky përfundim u përdor për ndryshimin e datës zyrtare të përkujtimit në atë periudhë. Studimi i Ana Lalajt e dokumenton relacionin, por kritikon argumentet mbi të cilat ishte mbështetur. Për argumentet që mbështesin këtë përfundim, mund të përdoret edhe shkrimi i historianit Kasem Biçoku: Kasem Biçoku – Argumentet për çlirimin e Shkodrës më 28 nëntor 1944.

Nga dëshmitë e dhëna përfundimisht nxjerrim se fakti më konkret në mbështetje të 28 nëntorit 1944 është procesverbali i 5 nëntorit 1945, që diskuton largimin e pushtuesve nga Shkodra.

FINESA IBISHI

5619 vajza dhe gra në Kosovë mbajnë emrin Vlora

Para se të vazhdojmë me dëshmi statistikore, duhet përmendur vlera e emrit Vlora dhe pse një numër aq i madh i vajzave dhe grave në Kosovë kanë këtë emër. Emri Vlora vjen nga qyteti i Vlorës, i cili përmban vlera historike për shkak se ngritja e flamurit nga Ismail Qemali ishte bërë pikërisht në këtë vend. Pra, emri Vlora ka lidhje me vlerat e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ditë që ka rëndësi të madhe për të gjithë shqiptarët anembanë botës.

1. Dëshmia statistikore: 5619 vajza dhe gra me emrin Vlora në Kosovë:

Burimi i parë – ATV, bazuar në statistikat e ASK-së

Artikulli "Statistikat tregojnë se emrat kombëtarë mbizotërojnë në familjet kosovare" përmban pikërisht shifrën 5619 dhe shpërndarjen e saj sipas komunave. Sipas të dhënave kuptojmë që vendi me më së shumti vajza dhe gra me emrin Vlora është Prishtina me 878 persona.

Burimi i dytë – Agjencia e Statistikave të Kosovës

ASK ka platformën zyrtare Kërko Emrin – ASK, ku mund të kërkohet emri Vlora dhe të kontrollohet shpërndarja sipas komunave. Platforma është burimi institucional më i përshtatshëm për këtë verifikim.

Saktësim statistikor: Numri 5619 gjendet shprehimisht në artikullin e ATV-së, prandaj shifra duhet cituar si e raportuar nga media sipas ASK-së, jo si numër i verifikuar në mënyrë të pavarur në bazën e saj.

Për krahasim, KOHA raportonte 5565 persona me emrin Vlora më 28 nëntor 2024, ndërsa një artikull i saj i vitit 2023, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, raportonte 5832. Këto shifra u përkasin publikimeve dhe burimeve të ndryshme statistikore.

FINESA IBISHI

Adem Jashari – heroi i heronjëve të UÇK-së

Drenica lind veç trima, dhe pikërisht më 28 nëntor 1955, lindi trimi më i madh i Drenicës, Adem Jashari. Fati deshi që ardhja e tij në këtë botë të ishte në të njëjtën ditë me Pavarësinë e Shqipërisë. Duket sikur vetë historia e kishte vulosur që në djep misionin e tij të madh, që të bëhej simboli i lirisë dhe i sakrificës së kombit tonë. Ashtu siç 28 Nëntori shënon rilindjen dhe krenarinë kombëtare, edhe jeta e Komandantit Legjendar shënoi lindjen e shpresës për lirinë e Kosovës. Ai u rrit në kullat e Prekazit me dashurinë e pafundme për atdheun, duke e kuptuar se liria nuk dhurohet, por fitohet me gjak dhe mund. Në çdo hap të jetës së tij, Ademi dëshmoi se liria e atdheut ishte mbi gjithçka, duke bashkuar rreth vetes breza luftëtarësh nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sot, sa herë që festojmë 28 Nëntorin, nuk kujtojmë vetëm shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë, por nderojmë me krenari të pafund edhe ditëlindjen e heroit që na fali lirinë. Adem Jashari lindi në ditën e Pavarësisë dhe ra për të, duke mbetur përgjithmonë i pavdekshëm në zemrën e çdo shqiptari.

POMENA DAKAJ

Shkolla që mban emrin 28 Nëntori – SHMT “28 Nëntori”, Prishtinë

Që nga themelimi i saj në vitin 1947 në Prishtinë, Shkolla e mesme teknike “28 Nëntori” mban një emër që është dëshmi e vetë datës historike të 28 Nëntorit. Duke mbajtur ditën e Pavarësisë së Shqipërisë të vitit 1912, ky emërtim tregon se si kujtimi i kësaj dite të madhe jeton fuqishëm edhe në Kosovë, duke i lidhur të dyja vendet përmes historisë dhe trashëgimisë. Me këtë emër në kryeqytetin e Kosovës, ruhet kujtimi i 1912-ës dhe i të gjitha përpjekjeve të përbashkëta për liri. Kjo tregon se 28 Nëntori nuk i përket vetëm një vendi apo një kohe, por i bashkon shqiptarët kudo që janë. Duke mbajtur këtë datë që nga viti 1947, shkolla mbetet një dëshmi e fortë mes Kosovës dhe Shqipërisë, ku kujtimi i 28 Nëntorit të vitit 1912 vazhdon të afrojë të dyja anët. Prania e kësaj date në Prishtinë dëshmon se rrugëtimi i përbashkët dhe lidhja mes të dy vendeve nuk janë zbehur kurrë, por jetojnë ende me të njëjtën peshë e rëndësi.

POMENA DAKAJ

Riatdhesimi i eshtrave të Naim Frashërit me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë


DRITA

FLETORE E PËRDITËSHME PARIMESH NACIONALISTE

NJË GJEST MALLENGJYËS I SOVRANIT

L.M.Tij Mbreti jep urdhër Qeveris, të dërgojë një Komision në Stamboll, për të sjellë n'Atdhé eshtrat e Naim Frashërit

SHPENZIMET I MBULON L. M. TIJ VETË

Marshimi ngallnjyes i nasjonalistave në sektorët e rretheve të Madridit i tremb të kuqët

Mbreti i Greqi... do të veië në Turki?

Riatdhesimi i eshtrave të Naim Frashërit u organizua me urdhër të Mbretit Zog I në kuadër të 25-vjetorit të Pavarësisë, si një akt nderimi shtetëror për "Apostullin e shqiptarizmës" dhe si një simbol i fuqizimit e bashkimit kombëtar të shtetit shqiptar. Më 11 janar 1937, Mbreti Zog urdhëroi qeverinë të dërgonte një komision të posaçëm në Stamboll (duke mbuluar vetë shpenzimet). Eshtrat u morën nga varrezat bektashiane të *Merdivenköy*-t, ku poeti prehej që prej vdekjes së tij në tetor të vitit 1900 pranë të vëllait, Abdylit.

Mbërritja madhështore në Tiranë (2 qershor). Të mërkurën e 2 qershorit, në orën 15:30, kortezhi mbërriti në Tiranë. Arkivoli, i zbukuruar me vija kuqezi, iu dorëzua nga Komandanti i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, nënkoloneli Shefki Shatku, kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Abedin Nepravishtës.

Qindra qytetarë të Tiranës, personalitetet më të larta të shtetit, krerët fetarë, figura të kulturës dhe përfaqësues të familjes (si Eshref Frashëri) morën pjesë në ceremoni. Shtypi i kohës e përshkroi me fjalët: *"Shqipëria e lirë pret me mallëngjim ligjëronjësin e shqiptarizmës"*.

Rivarrimi në teqenë bektashiane. Duke respektuar përkatësinë dhe besimin e tij bektashi, arkivoli u përcoll me solemnitet në oborrin e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane në periferi të Tiranës (ku më 3 qershor u krye ceremonia e vendosjes dhe më vonë u ndërtua një varr monumental prej mermeri të bardhë).

URAN ZEQIRI

Kaliopi Naska – biografja e Ismail Qemalit



Ka lindur në Tiranë në vitin 1952. Studimet universitare i ka mbaruar në Fakultetin e Histori-Gjeografisë në Universitetin e Tiranës më 1976. Ka punuar arsimtare, punonjëse shkencore në Institutin e Historisë pranë Akademisë së Shkencave, nëndrejtore në Arkivin Qendror Shtetëror, zëvendësrektore dhe dekane e Fakultetit të Shkencave Politike në Universitetin Illyria, Tiranë.

Ka shërbyer si punonjëse shkencore në Institutin e Historisë pranë Akademisë së Shkencave, nëndrejtore e Arkivit Qendror Shtetëror të Shqipërisë, si dhe dekane e Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanian University.

Në një koincidencë domethënëse me vitin e saj të lindjes, një pjesë e madhe e punës së saj kërkimore i kushtohet pikërisht dokumenteve të Rilindjes Kombëtare, Shpalljes së Pavarësisë, Këshillit Kombëtar të vitit 1920 dhe historisë së parlamentarizmit shqiptar. Në kuadër të kësaj hyn vepra e saj kushtuar Ismail Qemalit, që trajton përpjekjet për autonominë dhe pavarësinë e Shqipërisë, si dhe rolin e tij në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Ajo tregon se veprimtaria e tij ishte pjesë e një procesi të gjatë historik, gjatë të cilit kërkesat për autonomi u shndërruan në përpjekje për krijimin e një shteti të pavarur shqiptar.

URAN ZEQIRI

Kremtimi i Ditës së Flamurit për herë të parë në SHBA nga “VATRA”, më 28 nëntor 1913



Për herë të parë festa e 28 Nëntorit u kremtua në SHBA, më 28 nëntor 1913, në Boston, e organizuar nga Federata Panshqiptare “VATRA”. Kremtimi i 28 Nëntorit në Boston më 28 nëntor 1913 zë një vend të veçantë në historinë e shqiptarëve të Amerikës.

VATRA u themelua më 28 prill 1912 në Boston, me synimin për të bashkuar shoqëritë shqiptare që vepronin në Shtetet e Bashkuara. Ndër figurat e rëndësishme të lidhura me krijimin dhe organizimin e saj ishin: Paskal Aleksi, Kristo Floqi, Faik Konica dhe Fan S. Noli.

Edhe pse Shqipëria po kalonte sfida të rënda pas shpalljes së Pavarësisë më 28 nëntor 1912, diaspora në SHBA organizoi kremtimin për të mbajtur gjallë identitetin dhe çështjen kombëtare.

Kjo ngjarje ka rëndësi të veçantë për historinë e diasporës, sepse tregon se shqiptarët e Amerikës nuk e konsideronin Pavarësinë vetëm si një ngjarje që i përkiste popullsisë brenda kufijve të Shqipërisë, por si një fitore të të gjithë kombit shqiptar.

DARIS ZAKUTI

28 nëntor 1443 – ngritja e flamurit në Krujë



Ngritja e flamurit në Krujë më 28 nëntor 1443 është një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë shqiptare. Ajo lidhet me emrin e heroit kombëtar, Gjergj Kastriotit – Skënderbeut.

Në shekullin XV, trojet shqiptare përballeshin me zgjerimin e Perandorisë Osmane në Ballkan. Pas betejave dhe pushtimeve të njëpasnjëshme, shumë territore shqiptare kishin rënë nën kontrollin osman. Kjo periudhë solli ndryshime të mëdha politike, ekonomike dhe shoqërore.

Data 28 nëntor 1443 lidhet me marrjen e Kalasë së Krujës nga Skënderbeu dhe ngritjen e flamurit të Kastriotëve, me shqiponjën e zezë dykrenare në fushë të kuqe.

Flamuri i ngritur në Krujë u bë simbol i:

- *Lirisë dhe pavarësisë.*
- *Identitetit kombëtar shqiptar.*
- *Bashkimit të shqiptarëve.*
- *Qëndresës kundër pushtimit osman.*
- *Trashëgimisë historike të familjes Kastrioti.*

DARIS ZAKUTI

Liri për valëvitjen e flamurit kuqezi

Flamuri kuqezi, i ngritur më 28 nëntor 1912 në Vlorë nga Ismail Qemali, është simbol i historisë, krenarisë dhe identitetit kombëtar shqiptar. Për shqiptarët e Kosovës, ky flamur kishte një domethënie të veçantë. Për shumë vite, përdorimi i tij ishte i ndaluar dhe mbajtja e tij shpesh shoqërohej me pasoja të rënda. Një moment i rëndësishëm ndodhi në tetor të vitit 1968, kur u lejua përdorimi publik i flamurit kombëtar. Në vitin 1969, kjo e drejtë u sanksionua edhe në kuadrin kushtetues të Kosovës. Ky zhvillim ishte një ngjarje e rëndësishme për shqiptarët, të cilët e shihnin flamurin jo vetëm si simbol, por edhe si dëshmi të përkatësisë dhe identitetit të tyre kombëtar. Flamuri kuqezi që u ngrit në Vlorë dhe u valëvit me krenari në Kosovë mbetet simbol i bashkimit, historisë dhe kujtesës sonë kombëtare.

MAL KASEMI

20-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë u shënua me ngritjen e varrit monumental të Ismail Qemalit



Më 28 nëntor 1932, në kuadër të kremtimit të 20-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në qendër të Vlorës u ngrit dhe u përurua varri monumental i Ismail Qemalit, burrështetasit që udhëhoqi shpalljen e Pavarësisë më 28 nëntor 1912. Monumenti përfshin skulpturën e njohur "Flamurtari", vepër e artistit shqiptar Odhise Paskali.

Ky monument u bë një simbol nderimi dhe mirënjohjeje për figurën e tij historike dhe për kontributin e dhënë në themelimin e shtetit shqiptar. Ai mbetet një vend me rëndësi të veçantë për historinë dhe kujtesën kombëtare shqiptare. Ruan kujtimin e ngjarjes historike të 28 Nëntorit 1912 dhe përcjell te brezat e rinj rëndësinë e ruajtjes së lirisë, identitetit dhe trashëgimisë kombëtare.

MAL KASEMI

28 Nëntor 1962 me rastin e 50 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë u zhvendos qeveria shqiptare nga Tirana në Vlorë.

Më 28 nëntor 1962, Shqipëria festoi 50-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë, një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar. Me këtë rast, qeveria shqiptare u zhvendos nga Tirana në Vlorë, qytetin ku më 28 nëntor 1912 Ismail Qemali shpalli Pavarësinë e Shqipërisë dhe ngriti flamurin kombëtar. Kjo zhvendosje kishte një rëndësi të veçantë historike dhe simbolike, sepse Vlora përfaqëson vendin ku filloi një kapitull i ri për popullin shqiptar. Ajo ishte një mënyrë për të nderuar figurat historike që kontribuuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Gjatë këtyre festimeve, qyteti i Vlorës u bë qendra e aktiviteteve përkujtimore dhe e kremtimit të kësaj ngjarjeje. Përvjetori shërbeu si një kujtesë për sakrificat dhe përpjekjet e brezave të mëparshëm për krijimin e shtetit shqipëtar. Kjo dëshmi tregon se 28 Nëntori nuk është vetëm një datë në kalendar, por një simbol i lirisë, bashkimit dhe identitetit kombëtar shqiptar.

ADEA BYTYÇI

4361 Persona në Kosovë mbajnë emrin flamur për nder të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912.


28 Nëntori është një datë me rëndësi të veçantë për popullin shqiptar, sepse më 28 nëntor 1912, në Vlorë, Ismail Qemali shpalli Pavarësinë e Shqipërisë dhe ngriti flamurin kombëtar. Kjo ngjarje u bë simbol i lirisë, krenarisë dhe identitetit kombëtar shqiptar.

Një dëshmi interesante e rëndësisë së kësaj date është fakti se 4361 persona në Kosovë mbajnë emrin Flamur. Ky emër lidhet drejtpërdrejt me flamurin kombëtar dhe me historinë e shqiptarëve. Shumë prindër e kanë zgjedhur këtë emër për fëmijët e tyre si shenjë dashurie për atdheun, respekti për historinë dhe krenarie për prejardhjen e tyre. Flamuri nuk është thjesht një simbol me ngjyra, por përfaqëson historinë, sakrificat dhe përpjekjet e shumë brezave për liri. Prandaj, emri Flamur mbart një kuptim të veçantë dhe përcjell një mesazh të rëndësishëm nga një brez te tjetri. Kjo dëshmi tregon se kujtimi i 28 Nëntorit vazhdon të jetojë jo vetëm përmes festimeve, por edhe përmes emrave që mbajnë njerëzit në Kosovë.

ADEA BYTYÇI

Nëntori i dytë: filmi, skenografia dhe kinematografia shqiptare e asaj kohe

Rreth filmit



"Nëntori i dytë" është një film artistik historik shqiptar, i prodhuar në vitin 1982 nga Kinostudioja "Shqipëria e Re", me regji të Viktor Gjikës dhe skenar të Dhimitër Shuteriqit e Kiço Blushit. Filmi trajton Shpalljen e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912, udhëtimin drejt Vlorës, përpjekjet e Ismail Qemalit, Isa Boletinit dhe patriotëve shqiptarë, si edhe rrezikun e copëtimit të vendit. Në rolet kryesore interpretojnë Sandër Prosi, Reshat Arbana, Mario Ashiku dhe Robert Ndrenika. Kinematografia është realizuar nga Lionel Konomi, ndërsa muzika nga Kujtim Laro. Premiera u dha në vitin 1982; filmi zgjat rreth një orë e 25 minuta dhe është në gjuhën shqipe.

Skenografia dhe rikrijimi i epokës

Skenografia e filmit ndihmon në rikrijimin e Shqipërisë së fillimshekullit XX dhe në përcjelljen e atmosferës së një periudhe vendimtare. Hapësirat e Vlorës dhe rrugëtimi i delegatëve krijojnë ndjesinë e një udhëtimi të vështirë, ndërsa ambientet e brendshme ku

zhvillohen bisedimet, shtëpitë, zyrat dhe vendet e mbledhjeve e vendosin veprimin në një mjedis të besueshëm historik.

Një rol të rëndësishëm kanë edhe kostumet tradicionale, uniformat, armët, dokumentet dhe flamuri kombëtar. Ngjyrat, objektet dhe arkitektura bashkohen për të krijuar atmosferën e kohës dhe për ta bërë bindëse skenën kulmore të ngritjes së flamurit. Në këtë mënyrë, skenografia nuk shërben vetëm si sfond, por e mbështet drejtpërdrejt rrëfimin dhe emocionin e ngjarjes historike.

Kinematografia shqiptare e asaj kohe



Gjatë periudhës së Kinostudios “Shqipëria e Re”, veçanërisht në vitet 1970–1980, kinematografia shqiptare u zhvillua përmes filmave që trajtonin tema historike, patriotike dhe shoqërore. Regjia, fotografia, muzika, kostumet dhe interpretimi i aktorëve ndërtonin së bashku një gjuhë të dallueshme të filmit shqiptar, me vëmendje te historia, kujtesa kolektive dhe përvojat e shoqërisë.

Filmat historikë kërkonin kërkim mbi ngjarjet, rikrijim të mjediseve dhe përdorim të figurave kombëtare për ta sjellë të kaluarën në ekran. Në këtë kontekst, “Nëntori i dytë” mbetet një shembull i rëndësishëm i mënyrës se si kinemaja e asaj kohe e paraqiste historinë dhe identitetin kombëtar, duke e lidhur ngjarjen e Pavarësisë me përpjekjet, sakrificat dhe idealin e bashkimit.

Vlera e filmit qëndron jo vetëm te paraqitja e një ngjarjeje historike, por edhe te bashkimi i skenarit, interpretimit, skenografisë, kostumeve, muzikës dhe fotografisë filmike në një rrëfim për kujtesën dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Aktorë dhe rolet e tyre në film

Aleksandër Prosi	Vangjel Grabocka
Ismail Qemali	plaku Kozi
(as Sandër Prosi)	Sulejman Dibra
Bujar Lako	Oficeri turk
Luigj Gurakuqi	Agim Shuke
Reshat Arbana	Jani Minga
Isa Boletini	Luan Qerimi
Viktor Zhusti	Sali Drenica
Pandali Cala	Ilia Shyti
Mario Ashiku	mullai i Beratit
Shpend Dragobia	Spiro Urumi
Robert Ndrenika	Beu
Karrocieri	Piro Malaveci
Pandi Raidhi	Hasan Prishtina
Demir Arbana	Hajrie Rondo
Vangjel Heba	gruaja e Lym Kepit
Dhespoti	

Për më shumë informata rreth filmografisë Shqiptare: https://www.movingimagearchivenews.org/saving-albanias-film-legacy/

Festivali i Plisit

28 nëntor 2022 në Prishtinë u organizua Edicioni I Parë i Festivalit të Plisit



Festivali i Plisit u mbajt më 28 nëntor 2022, në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, në kuadër të shënimit të 110-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Ky ishte edicioni i parë i festivalit dhe kishte për qëllim promovimin e kulturës dhe traditës shqiptare, veçanërisht te gjeneratat e reja.

Festivali u organizua nga organizata joqeveritare "Me dhe për Kulturën", me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Prishtinës.

1. Pse u mbajt Festivali i Plisit?

Festivali u mbajt për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore shqiptare dhe për t'i afruar të rinjtë me traditat e tyre. Organizatorët dëshironin që plisi të mos shihej vetëm si një veshje e së kaluarës, por si një simbol kulturor që duhet të ruhet dhe të përcillet edhe te brezat e ardhshëm.

Një tjetër synim ishte që kjo traditë të promovohej jo vetëm në trojet shqiptare, por edhe jashtë tyre, në mënyrë që më shumë njerëz të njiheshin me kulturën shqiptare.

2. A është plisi i mbrojtur nga UNESCO?

Jo, plisi ende nuk është i regjistruar në listën e UNESCO-s për Trashëgiminë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit.

Megjithatë, ekzistojnë përpjekje për ta promovuar dhe për ta përfshirë në këtë listë, për shkak të rëndësisë së tij historike dhe kulturore.

Është me rëndësi të mos ngatërrohet plisi me xhubletën, sepse xhubleta shqiptare është përfshirë nga UNESCO në vitin 2022 në Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Nevojë për Mbrojtje Urgjente.

3. Çfarë rëndësie ka skulptura e plisit në sheshin Skënderbeu dhe kush e ndërtoi?

Një nga pjesët më të veçanta të festivalit ishte vendosja e një skulpture gjigante të plisit në sheshin “Skënderbeu”. Ajo ishte 2 metra e 10 centimetra e lartë dhe ishte punuar nga gipsi.

Skulptura kishte rëndësi simbolike, sepse përfaqësonte identitetin dhe trashëgiminë shqiptare. Qëllimi ishte që plisi të prezantohej jo vetëm si një veshje tradicionale, por edhe si një simbol kulturor që meriton të ruhet dhe të vlerësohet.

Skulptura u realizua nga skulptori Daors Hoxha, së bashku me një person tjetër. Sipas tij, për realizimin e saj u punua për gjashtë ditë dhe gjashtë net. Qytetarët patën mundësi të linin nënshkrimet e tyre në skulpturë, e cila ishte menduar të ruhej në arkivat e Prishtinës.

4. Disa fakte interesante për festivalin

- U mbajt më 28 nëntor 2022.
- Ishte edicioni i parë i Festivalit të Plisit.
- U shpërndanë rreth 500 plisa falas për qytetarët.
- Skulptura gjigante ishte 2.10 metra e lartë.
- Organizatorët synonin që festivali të shndërrohej në traditë të përvitshme.





